

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

VENDIM

NR 62 DATE 25.06.07

PER TARIFAT E LEJEVE VETERINARE

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 25/ 06/2007 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve "Per tarifat e lejeve veterinare" duke u mbeshtetur ne ligjin Nr 8652 date 31.07.2000" Per Organizimin e Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" kreu III, neni 8-III, paragrafi "b" "Per taksat dhe tarifat per sherbimet"; Kreu XI, Neni 73, Pika 2 paragrafi C "Per tarifa administrative per leje, licenca, autorizime, certifikata dhe dokumentacionin zyrtar; kreu VI neni 32 pika k, mbeshtetur ne ligjin Nr 9308 date 04.11.2004 "Per Sherbimin dhe Inspektoriatin veterinar" kreu I neni 3 pika 3.

VENDOSI:

1. Te miratoje modularin "Leje veterinare" me afat 1-vjecar per subjektet qe kane aktivitet perpunimin, transportimin, ruajtjen dhe tregetin e prodhimeve ushqimore me origjine shtazore si dhe te klinikave e farmacive veterinare.

2. Te caktoje tarifat per lejet veterinare si me poshte:

- Leje veterinare per thertore,,sallameri 3 000 leke.
- Stabilimentet frigoriferike qe ruajne dhe tregetojne me shumice prodhime me origjine shtazore 5 000 leke.
- Njesite e tregetit te mishit ,bulmetit,peshkut 2 000 leke.
- Fastfudet,picerite 2 000 leke
- Pasticerite, akulloret 1 000 leke.
- Mjetet e transportit te produkteve blektorale 1 000 leke.
- Farmacite dhe klinikat veterinare 2 000 leke.

3. Per zbatimin te ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve,Drejtoria e Tatim-taksave,Drejtoria e Finances dhe Drejtoria e Policise Bashkiake .

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
VASILIKA HOXHA

